

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 29/01/2024 në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

SHITËSI: Z. Renis TËRSHANA, lindur më 23.09.1971, në Tiranë, shtetas Shqiptar, me adresë Rr. Elbasanit, Pallati Tërshana 2, 01101, Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. Personal H10923040R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në cilësinë e **Shitësit**).

DHE

BLERËSI: Z. Kujtim SPAHIU, i biri i Fadilit, lindur në Tiranë, më 15.02.1957, shtetas Shqiptar, me adresë: Rruga: Haxhi Kika, Nd.7, H5, Ap.8, Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. Personal F70215190B (në cilësinë e **Blerësit**).

OBJEKTI: Shitja e 29,264 (njëzet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) aksioneve të "BANKA CREDINS" sh.a, që zotërohen nga aksioneri **Z. Renis TËRSHANA** dhe blerja e tyre nga **Z. Kujtim SPAHIU**.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria "BANKA CREDINS" sh.a., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K31608801O, si dhe me licencën nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS

Palët kanë rënë dakord që 29,264 (njëzet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) aksione të shiten me një çmim 1.7 euro/aksion, me çmimin total prej 49,748.8 (dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë pikë tetë) Euro.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins me nënshkrimin e kontratës.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE



Shitësi është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **Blerësit** 29,264 (njëzet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" sh.a, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.

Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës 49,748.8 (dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë pikë tetë) Euro nga ana e Blerësit **Z. Kujtim SPAHIU**, në llogarinë e Shitësit **Z. Renis TËRSHANA**.

KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votës, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejte tjetër e papërmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji. Përfitimi i këtyre të drejtave bëhet së bashku me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi tek Blerësi me pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve.

LIGJI I ZBATUESHËM


Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.

TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

SHITËSI

Renis TËRSHANA



BLERËSI

Kujtim SPAHIU

